LIGJ
Nr. 42/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 79/2017, "PËR SPORTIN", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 79/2017, "Për sportin", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

"6/1. "Fondacionet në fushën e sportit" janë organizata jofitimprurëse të themeluara nga institucionet publike, persona juridikë dhe fizikë, që administrojnë apo ushtrojnë veprimtari sportive. Fondacionet në fushën e sportit, të themeluara nga institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, mund të financohen nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.".

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

"9. "Këshilli i Arbitrazhit Sportiv" është organizatë e pavarur jofitimprurëse, që krijohet në formën e qendrës, e cila drejton, autorizon, mbikëqyr, kontrollon dhe vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nëpërmjet trupave të gjykimit të mosmarrëveshjeve.".

3. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. "Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar" është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen paralimpike në Shqipëri.".

4. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

"13/1. "Lëvizja paralimpike" është organizim universal dhe i përhershëm për individët me aftësi fizike të kufizuara dhe subjektet, që janë frymëzuar nga vlerat e olimpizmit në të pesta kontinentet e që kryhet nën autoritetin e Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar.".

5. Pika 16 ndryshohet si më poshtë:

"16. "Organizatë sportive" është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, federatat sportive, Olimpiku Special Shqiptar, klubet sportive, shoqëritë sportive dhe shoqatat sportive dhe fondacionet në fushën e sportit, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.".

6. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

"17/1. "Olimpiku Special Shqiptar" është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike speciale për personat me aftësi intelektuale të kufizuara në Shqipëri.".

Neni 2

Në nenin 6 pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe në institucionet e arsimit të lartë organizohen jashtë procesit mësimor edhe nga institucionet shtetërore dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar me projekte për zhvillimin e sportit.".

Neni 3

Në nenin 11 shtohen shkronjat "a/1", "a/2" dhe "c/1" me këtë përmbajtje:
"a/1. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar;
a/2. fondacionet në fushën e sportit;
...
c/1. Olimpiku Special Shqiptar.".

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13

Financimi i organizatave sportive dhe i aktiviteteve sportive ndërkombëtare

1. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, Olimpiku Special Shqiptar, federatat sportive, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv dhe fondacionet sportive me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transferte, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, federatat sportive olimpike, fondacionet sportive me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv financohen nga buxheti i shtetit në formë transferte. Kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së grantit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministria përgjegjëse për sportin financon Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Olimpikun Special Shqiptar, federatat joolimpike dhe fondacionet sportive me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, me projekte nga buxheti i saj në formë transferte për veprimtari të propozuara prej tyre. Kriteret, procedurat e aplikimit dhe të shqyrtimit, mënyra e përzgjedhjes së projekteve dhe procedura e financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Aktivitetet sportive me karakter ndërkombëtar me impakt social, kulturor, ekonomik dhe turistik në vend, në rastet kur vendoset të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë me propozimin e ministrisë përgjegjëse për sportin, financohen sipas procedurave dhe kritereve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministria përgjegjëse për sportin monitoron e kontrollon në mënyrë periodike, sipas legjislacionit buxhetor, veprimtarinë dhe administrimin e transfertës së buxhetit të shtetit në të gjitha organizatat sportive, që kanë përfituar nga fondet publike.".

Neni 5

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/1

Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar

1. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar janë persona juridikë, që organizohen dhe funksionojnë në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpike dhe statutin e tij të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.

2. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Paralimpike Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, mbështetet në parimet e sistemit ndërkombëtar të sporteve paralimpike dhe në rezolutat e udhëzimet e nxjerra nga Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar.

3. Olimpiku Special Shqiptar është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpike Speciale Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me marrëveshjen e licencës së akreditimit të Olimpikut Special Botëror "Special Olympics".

4. Statuti dhe ndryshimet statutore të Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpikut Special Shqiptar miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit. Pas kalimit të këtij afati, statuti dhe ndryshimet statutore konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, statuti dhe ndryshimet statutore regjistrohen në gjykatë.

5. Ministria përgjegjëse për sportin njeh vetëm një Komitet Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe vetëm një Olimpik Special Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e tyre.

6. Në Komitetin Paralimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare, shoqata, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë, që në statut kanë të përfshirë veprimtari për persona me aftësi fizike të kufizuara, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij komiteti.

7. Në Olimpikun Special Shqiptar mund të aderojnë federatat shqiptare, ku kanë të përfshirë olimpikun special dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë e fizikë, të cilët plotësojnë dhe pranojnë kushtet e përcaktuara në statutin e tij." .

Neni 6

Pika 2 e nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

"2. "Këshilli i Arbitrazhit Sportiv" është organizatë e pavarur jofitimprurëse, që krijohet në formën e qendrës, e cila drejton, autorizon, mbikëqyr, kontrollon dhe vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nëpërmjet trupave të gjykimit të mosmarrëveshjeve.".

Neni 7

Në nenin 42 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

"1/1. Lojërat olimpike speciale dhe veprimtaritë me karakter olimpik special organizohen nga Olimpiku Special Shqiptar.

1/2. Lojërat Paralimpike dhe veprimtaritë me karakter paralimpik organizohen nga Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar.".

2. Në pikën 3 pas fjalëve "Për organizimin e lojërave olimpike" shtohen fjalët "olimpike speciale dhe paralimpike ".

Neni 8

Në pikën 5 të nenit 44 pas fjalëve "sipas Konventës Evropiane Antidoping" shtohen fjalët "dhe Agjencisë Botërore Antidoping".

Neni 9

Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 58/1

Financimi i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, i Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe i Olimpikut Special Shqiptar

1. Olimpiku Special Shqiptar realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon 9 (nëntë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon 24 (njëzet e katër) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon 24 (njëzet e katër) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.".

Neni 10

Akte nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 të këtij ligji miratohen brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 252, datë 21.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.